REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE**

**KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

**Nr. 7/2020 (JR)** **Tiranë më 17.12.2020**

**dt. 7/6 regj.**

**SHPALLJE**

**E**

**NJOFTIMIT PËR ZHVILLIMIN E GJYKIMIT TË ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE**

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, bazuar në nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se sot, më datë 17.12.2020, ora 10.00, pasi mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen me numër regjistri (JR) 7/2020, datë 05.02.2020, për ankimin e subjektit të rivlerësimit Astrit Haxhialushi kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 225, datë 07.01.2020, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe në nenin 51, pika 1, germa "b" e ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, vendosi që gjykimi i çështjes të vijojë në seancë gjyqësore publike për t'i dhënë mundësi subjektit të rivlerësimit Astrit Haxhialushi të dëgjohet dhe mbrohet për çështjen e tij. **Seanca gjyqësore publike do të jetë më datë 28. 12. 2020, ora 10:00.**

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykues, përbëhet nga gjyqtarët:

| | |
|---|---|
| **Kryesuese e Trupit Gjykues** | **Albana Shtylla** |
| **Relatore e Çështjes** | **Ina Rama** |
| **Gjyqtar** | **Ardian Hajdari** |
| **Gjyqtare** | **Natasha Mulaj** |
| **Gjyqtare** | **Rezarta Schuetz** |

Bazuar në nenin 460, pika 5 e Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 51, pika 2 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, kjo shpallje bëhet të paktën 10 ditë para seancës gjyqësore, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe atë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit.

**KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES**

**GJYQTARE**

**ALBANA SHTYLLA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT - SEKRETARIA - GJYKATA KUSHTETUESE - TIRANË